

# MËSIMI I MISSIONIT

Viti 1 – Tremujori 1

## Fluturim në vende ku ndalohet Ungjilli

**Qëllimi:** Prezantoi nxënësit me punën misionare në rajonin e Lindjes së Mesme dhe ndihmoji të kuptojnë misionet në vendet ku ndalohet Ungjilli.

### Mjetet:

- Mjetet për rregullimin e klasës:
  - Avionë dhe karrige (përdor kartonë, plastikë etj., për të ndërtuar muret e avionëve; vendos rreshtat me karrige brenda avionit)
  - Televizor ose një hartë të madhe të botës ku tregohen fluturimet dhe oraret e tyre (fluturimi nga vendi juaj deri në rajonin e Lindjes së Mesme dhe me ndalesë në Stamboll, Turqi)
- Përdorni video në Youtube ose burime të ngjashme, dhe mbani gati tingujt e mëposhtëm:
  - Zhurma e një avioni që niset
  - Zhurma e një avioni që ulet
- Uniformë stjuardese (xhaketë, kollare, kapele etj.) që ta veshë drejtuesi
- Çanta të vogla (nga një për çdo nxënës) – secila çantë duhet të mbajë të paktën një nga objektet e mëposhtme dhe një 'Libër pa fjalë' (çdo objekt përfaqëson një profesion):
  - Tabelë fjalësh – Bëj një listë me fjalë nga gjuha juaj, të cilat të kenë përbri përkthimin në një gjuhë të huaj (përkthyes)
  - Gozhdë ose thumba të vegjël (marangoz)
  - Fara perimesh për mbjellje (fermer)
  - Laps (mësues)
- Qerasje (biskota, çibukë ose diçka që mund të ta ofrojnë në avion) – Pyeti përpara nëse kanë alergji diçka

### Rregullimi i klasës:

- Rregulloje ambientin që të duket si një avion ku mund të futen nxënësit. Vendos karrige në rreshta siç janë në avion, dhe një rresht ku të ecë stjuardesa gjatë mësimit.
- Në fillim të avionit, vendos një televizor apo hartë të madhe të botës me fluturime dhe orare fluturimesh.

### Mësimi:

*Ndërkohë që nxënësit vijnë në klasë, secili prej tyre duhet të marrë një çantë të vogël. Stjuardesa duhet t'i udhëzojë t'i mbajnë afër vetes kur të niset avioni, dhe pastaj do të marrin udhëzime të tjera.*

Mirë se vini në fluturimin *DLG1212*, me shërbim nga \_\_\_\_\_ (emri i vendit tuaj) për në Stamboll, Turqi. Do të nisemi shumë shpejt. Ju kërkohet të mbani rripat e sigurimit gjatë gjithë kohës dhe të siguroni bagazhet nën ndenjese apo në pjesët e sipërme. Ju lutemi, fikni të gjitha pajisjet personale elektronike. Faleminderit që zgjodhët *DLG Airlines*. Fluturim të këndshëm!

*Vendosni zhurmën e nisjes së avionit.*

Ndërsa hipët në avion, duhet të keni marrë një çantë të vogël. Tani mund t'i hapni çantat. Çfarë shihni brenda? *Nxiti nxënësit të përgjigjen.* Secili prej objekteve përfaqëson një profesion:

- Ngrini dorën nëse keni gjetur makarona me shkronja apo listë fjalësh. Kjo do të thotë se ju punoni për qeverinë si përkthyes.
- Ngrini dorën nëse keni gjetur gozhdë/thumba në çantë. Kjo do të thotë se ju punoni si marangozë.
- Ngrini dorën nëse keni gjetur fara perimesh për mbjellje në çantë. Kjo do të thotë se punoni si fermerë.
- Ngrini dorën nëse keni gjetur një laps në çantë. Kjo do të thotë se ju punoni si mësues.

Keni gjithashtu edhe një 'Libër pa fjalë' në çantë. Kjo sepse, ju në të vërtetë, bëni dy punë. Punoni si përkthyes, marangozë, fermerë apo mësues, por jeni gjithashtu misionarë. Sot po fluturon drejt një vendi ku do të ndani Ungjillin. Duhet të dini disa gjëra të rëndësishme për këtë vend.

1. Së pari, nuk mund t'ju tregoj vendin. Kjo për shkak se konsiderohet si vend "i ndaluar". Nëse je misionar që po shkon atje, duhet ta ruash sekret vendndodhjen, sepse njerëzve në këtë vend nuk u lejohet të adhurojnë të vetmin Perëndi të vërtetë. Është e rrezikshme të jesh i krishterë në këtë vend.
2. Vende të tilla ka në të gjithë botën. Nëse do të shikoni fluturimet tona në ekran do të mund të shihni se sot po fluturojmë mbi rajonin e Lindjes së Mesme. Kjo për shkak se në Lindjen e Mesme ka shumë vende "të ndaluara". Do të zbresim në Stamboll, Turqi, por kjo është vetëm pjesa e parë e udhëtimit tonë. Shumë misionarë që shkojnë në vende të tilla, fillimisht shkojnë në Stamboll para se të shkojnë në vendin e tyre. Pasi të zbresim në Stamboll, do të niseni për në Lindjen e Mesme në drejtim të shtetit tuaj të ndaluar, ku do t'ju duhet të gjeni mënyra krijuese për ta ndarë Ungjillin ndërsa punoni si përkthyes, marangozë, fermerë apo mësues.
3. Shumë prej njerëzve që jetojnë në këtë shtet janë myslimanë, që do të thotë se nuk e njohin dhe nuk e adhurojnë Perëndinë e vërtetë. Është e jashtëligjshme të kesh një Bibël dhe të shkosh në kishë, prandaj ata nuk e kanë dëgjuar Lajmin e Mirë për Jezusin. Ata nuk e dinë se ka një Shpëtimtar që i do. Nëse dikush e ka dëgjuar këtë Lajm të Mirë, është shumë e vështirë për të që të bëhet i krishterë, sepse nuk lejohet të jesh i krishterë në këtë vend, dhe atij/asaj do t'i duhet të kthehet kundër traditave dhe fesë së të gjithë familjes.

Duhet të jesh shumë i mençur dhe krijues për të qenë misionar në një vend të tillë. Si mund të gjesh mënyra për të ndarë Ungjillin pa u kapur?

Perëndia i ka dhënë secilit prej jush dhunti dhe talente që të mund të ndihmojnë të tjerët të mësojnë për Jezusin. Ju do të hyni në këto vende të ndaluara duke punuar si përkthyes, marangozë, fermerë apo mësues, por ndërkohë që bëni këto gjëra, do të ndani edhe Ungjillin me shumë kujdes. Gjatë minutave të ardhshme, dua të punoni bashkë me pasagjerët e tjerë për të planifikuar se si do ta nisni punën apo biznesin në këtë vend dhe se si mund ta ndani Ungjillin me kujdes e t'u tregoni të tjerëve për Jezusin ndërsa punoni. Kur të vijë qerasjet, do të ketë përfunduar koha e planifikimit. Jini strategjik dhe krijues – kjo është e rëndësishme!

Mund të nisni me planifikimin në: tre, dy, një... nisuni!

*Nxënësit duhet të punojnë me njëri-tjetrin për rreth pesë minuta (siç janë të ulur në rreshta) për të planifikuar mënyra se si të punojnë e të ndajnë Ungjillin në vendet e ndaluara. Drejtuesit duhet t'i ndihmojnë nxënësit të planifikojnë duke bërë pyetje dhe duke ofruar udhëzime.*

*Bëj pyetjet e mëposhtme për t'i ndihmuar nxënësit të krijojnë planin e tyre:*

- Çfarë lloj biznesi do të hapni? Ose ku do të punoni?
- Me cilët njerëz do të ndërveproni në punë?
- Si mund ta ndani Ungjillin në mënyrë krijuese me këta njerëz?

*Kur të vijë koha e përfundimit të planit, nxirr qerasjet dhe shpërndajua nxënësve. Ata mund të hanë ndërsa planifikojnë.*

Cili është plani? Çfarë biznesi do hapni, ose ku do të punoni? *Nxiti nxënësit të ndajnë.*

Me cilët njerëz do të ndërveproni në punë? *Nxiti nxënësit të ndajnë.*

Si mund ta ndani Ungjillin në mënyrë krijuese me këta njerëz? *Nxiti nxënësit të ndajnë.*

Planifikime të tilla janë argëtuese, por është e rëndësishme të kujtojmë se ka misionarë të vërtetë në këto vende të ndaluara. Ata kanë zgjedhur të ndjekin e t'i binden Perëndisë, edhe kur është e rrezikshme. Ata janë përkushtuar për të ndarë Lajmin e Mirë të Jezusit me botën. Le të ndalemi dhe të lutemi për këta misionarë. Cilat janë disa nga gjërat për të cilat mund të lutemi? *Nxiti nxënësit të përgjigjen.*

**Nxënësit më të rritur:** Do të doja që të luteni me radhë me pasagjerët në rreshtin tuaj. Kur të përfundojë koha, unë do ta mbyll me një lutje.

**Nxënësit më të vegjël:** Unë do të lutem për misionarët në vendet e ndaluara. A do të luteni në qetësi me mua?

*Mbylle me një lutje.*

Faleminderit që fluturouat me ne sot. Ndërsa përgatitemi për të zbritur, ju lutemi mblidhni sendet tuaja dhe sigurohuni që të keni vënë rripat e sigurimit.

*Vendos zhurmën e uljes së avionit.*

Teksa dilni nga avioni, ju lutemi merrni me vete çantat e vogla. Kur t'i çoni në shtëpi, vendosini në një vend të dukshëm, që të kujtoni të luteni për misionarët të cilët po i shërbejnë Perëndisë në vendet e ndaluara.